



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:176586

Datë: 29.12.2022

Numri i dokumentit: 03813674

C.nr.1013/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NE LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarës Elvira Emini, gjyqtare individuale, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. P. nga L. të cilin me autorizim e përfaqëson av.Fidan Ibrahimimi nga Lipjani, kundër të paditurit M.T. nga L. rr.”L. e P.”, me objekt të kontesti vërtetim i drejtës së pronësisë, jashtë seancës gjyqësore me dt.04.06.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit N.P. nga L., kundër të paditurit M. T. nga L. rr.”L. e P.”, me objekt kontesti vërtetim i drejtës së pronësisë, në këtë çështje juridike kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi N. P. nga L. përmes të autorizuarit av. Fidan Ibrahimimi nga Lipjani, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit M. T. nga L. rr. “L. e P.”, me objekt kontesti vërtetim i drejtës së pronësisë.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore gjykata me anë të aktvendimit të datës 27.05.2021 e ka obliguar paditësin që në afatin prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë duke e përcaktuar vlerën e objektit të kontestit, dhe t'i sjellë në kopje të mjaftueshme provat edhe për palën e paditur, në të kundërtën nëqoftëse nuk i kthehet padia e plotësuar në afatin e caktuar do të konsiderohet se është tërhequr padia, e në qoftëse i kthehet e paplotësuar do të hedhet poshtë padia.

Në bazë të nenit 102.3 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet se “do të konsiderohet e tërhequr parashtrësja po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftëse se kthehet e pakorrigjuar, gjegjësisht e pa plotësuar do të hedhet poshtë”.

Gjykata vlerëson se i autorizuari i paditësit ka qenë i njoftuar në bazë të aktvendimit të dt. 27.04.2022 në kuptim të dispozitës së nenit 99.2 lidhur me nenin 102.1 të LPK-së, dhe meqenëse i njëjti brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e ka dorëzuar shpalljen e përkthyer e brenda afatit prej 7 ditësh, në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditësit e konsideroi si të tërhequr.

Gjyqtarja e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102.3 dhe 387 pika c të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMEORE NË PRISHTINË -DEGA NE LIPJAN

**Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1013/20 me dt. 04.06.2021**

GJYQTARJA
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.